

Faqe 12

UDHËZIME PËR LEXIM

Ky publikim mund të lexohet në mënyra të ndryshme:

► MUND TË ANALIZOSH OFERTËN EDUKUESE TË KRAHINËS DUKE PASUR PARASYSH LOKALIZIMIN E INSTITUTEVE TË NDRYSHME NËPËR TERRITOR

Në fakt, do të gjesh profile të ndryshme shkolle – duke përfshirë mundësitë e formimit profesional – të ndara në zona territoriale (ndarje e territorit të krahinës në zona më të vogla me karakteristika homogjene – lagje, qarqe, bashki...- në të cilat vendosen shkollat e krahinës).

► SHKOLLAT MUND TI GJESH NËPËRMJET NGJYRËS, NË BAZË TË 4 NDARJEVE TË MËDHA TË RRUGËVE TË ARSIMIT:

1. **arsim artistik** (vjollcë) që përfshin Institutin e Artit, Liceun Artistik, Konservatorin e Muzikës
2. **arsim klasik** (i kuq) që përfshin Liceun Klasik, Liceun Gjuhësor, Institutin Pedagogjik, Liceun Shkencor, Liceun Eksperimentues, Liceun e Komunikacionit.

Faqe 13

3. **arsim profesional** (portokalli) që përfshin Institutin Profesional të Bujqësisë dhe Ambientit, Institutin Profesional për Shërbimet e Hoteleve, Institutin Profesional të Shërbimeve Tregtare, Institutin Profesional të Industrisë dhe Artizanatit
4. **arsim teknik** (e verdhë) që përfshin Institutin Teknik të Aeronautikës, Institutin Teknik Tregtar, Institutin Teknik për Gjeometër, Institutin Teknik Industrial, Institutin Nautik (për lundrim), Institutin Teknik të Turizmit, Institutin Teknik të Aktiviteteve Sociale, Liceun Teknik

ËSHTË GJITHASHTU E MUNDUR TË GJESH ME LEHTËSI, GJITHMONË NËPËRMJET NGJYRËS, PROPOZIME PËR SHKOLLA TË MESME DHE PËR ATO TË FORMIMIT PROFESIONAL, SEPSE JANË TË KARAKTERIZUARA NGA NGJYRA TË NDRYSHME:

Ngjyra të nxehta: Institute të shkollës së mesme

Ngjyra të ftohta : Formim profesional

Faqe 14

SË FUNDI MUND TË PËRDORËSH EDHE TREGUESIN PËR TË GJETUR NË MËNYRË TË SHPEJTË INSTITUTIN OSE QENDRËN E FORMIMIT PROFESIONAL QË DËSHIRON TË ZGJEDHËSH

P.S.: Kujto që skedat informative të çdo shkolle dhe oraret që i përkasin kurseve të aktivuara ndodhen në dy seksione të ndara .

E ke më të thjeshtë të lexosh përpara karakteristikat e çdo instituti (adresën, telefonin, faxin, etj.), pastaj kurset e aktivuara dhe lokalizimin e tyre në territor, kurse në një seksion tjetër (nëpërmjet thirrjes së një faqeje) do të gjesh oraret e profileve të ndryshme shkollore.

Përpara se të shikosh konkretisht se çfarë një shkollë të ofron, kemi menduar të japim disa informacione të përgjithshme mbi **Arsimin** dhe **Detyrimin Shkollor**, ndërsa në përfundim, pas pjesës përshkruese, do të gjesh informacione të dobishme mbi të **Drejtën e Studimit**.

Faqe 15

Ky volum nuk pretendon të jetë i vetmi burim informacioni mbi realitetin shkollor-formues në territorin krahinor: siç mund të shikosh, në fakt, kemi zgjedhur të japim ekskluzivisht lajme homogjene mbi elementet kryesore që karakterizojnë çdo shkollë (orare, kurse të zakonshme, eksperimente, informacione të përgjithshme, etj.)

Të gjitha lajmet e tjera si psh. – praninë e mësuesve teknikë-praktikë dhe/ose të folësve të gjuhës mëmë, POF, aktivitetet extra-kurrikolare, projektet speciale, udhëzimet mbi strukturat dhe pajisjet e gatshme, etj - mund ti gjesh duke ia kërkuar drejtpërdrejt instituteve që të interesojnë
Lexim të mbarë!

Faqe 16

E DREJTA / DETYRIMI I ARSIMIT DHE EDUKIMIT

RRUGËT E MUNDSHME PËR NJË ZGJEDHJE TË PËRGJEGJSHME

Hyrje

Më 17 tetor 2005 Këshilli i Ministrave, në përputhje me Ligjin 53/2003 –e ashtëquajtura Reforma Moratti –ka miratuar Dekretin Legjislativ për rinovimin e shkollës së mesme, por vitet e para si të sistemit liceor ashtu dhe arsimit dhe formimit profesional do të nisin nga viti shkollor dhe formativ 2007/2008, "nëpërmjet përkufizimit të të gjitha përmbushjeve ligjore të parashikuara".

Si të vendosni cilën rrugë të merrni?

Është e rëndësishme që të mos zgjedhësh në mënyrë të nxituar, por të mendohesh me qetësi, duke marrë parasysh të gjithë faktorët që mund të njohësh: mbi të gjitha interesat e tua, prirjet dhe aftësitë e tua, por edhe realitetin që ke përreth.

Dialogu me prindërit, aktivitetet dhe iniciativat shkollore, këshillat e mësuesve janë burime për të njohur vetveten, informohu mbi mundësitë që ambienti të ofron, vlerëso mundësitë e ndryshme. Asnjë zgjedhje nuk të garanton një siguri absolute, sepse në çdo aventurë ka gjëra të panjohura, por, nëse vendimi yt (**Faqe 17**) bazohet në shpjegime të motivuara, do të jetë më e thjeshtë të përballosh gjëra të paparashikuara dhe vështirësi të mundshme. Në bazë të ligjeve në fuqi (Ligji 53/2003 e D.L,vo 76/2005) për të gjithë qëndron e drejta/ detyrimi i arsimit dhe formimit për të paktën dymbëdhjetë vjet, ose deri në marrjen e një kualifikimi me një zgjatje prej të paktën tre vjeçare brenda moshës tetëmbëdhjetë vjeç.

Si realizohet kjo e drejtë - detyrim?

Aktualisht, në pritje të Reformës së Shkollës së Mesme, mund të përmbushësh të drejtën-detyrimin e arsimit, duke zgjedhur tre mundësi:

- ▶ Të regjistrohesh në një shkollë të mesme
- ▶ Të regjistrohesh në një kurs experimental shkollor dhe të formimit profesional
- ▶ Të futesh në botën e punës, nëse ke mbushur 15 vjeç, me një kontratë Apendistati (periudhë e mësimi të profesionit), e finalizuar në marrjen e një kualifikimi profesional

Duhet të shikosh rreth e përçark dhe të kërkosh, me ndihmën e prindërve dhe mësuesve të tu, rrugët edukuese që ndodhen në zona të ndryshme territoriale që i përshtaten më mirë interesave të tua, aspiratave dhe prirjeve të tua.

SI TË REGJISTROHESH

Kërkesa për regjistrimin në vitin e parë të shkollës së mesme duhet:

- ▶ Ti adresohet drejtorit të shkollës të institutit të mesëm të përzgjedhur
- ▶ Të dorëzohet në shkollën tetëvjeçare të frekuentuar, e cila do të parashikojë për ta trazmetuar atë në institutin e mesëm, në të cilin është adresuar .

P.S.: kërkesa për regjistrim duhet paraqitur vetëm tek një institut i shkollës së mesme. Regjistrimi i të miturve të huaj në shkollat italiane të çdo niveli bëhet në të njëjtat mënyra dhe kushte si për të miturit italianë. Studentët e huaj mund të regjistrohen në çdo periudhë të vitit. (art. 45 D. Del P. Della Repubblica n. 394/99)

Materiali që vijon është furnizuar nga anëtarët e *Projektit të Integritit* që i falenderojmë shumë, i krahasuar me informacionet e përmbajtura në tekstin CESPI – *shkolla në vendet e origjinës së fëmijëve dhe të nxënësve imigrantë në Itali* – MURSIA 2003 dhe të verifikuara nga mediatorët kulturorë që janë marrë me përkthimin e këtyre faqeve.

SHKOLLA NËPËR BOTË, BOTA NËPËR SHKOLLA KRAHASIMI I SISTEMEVE SHKOLLORE

TABELË KRAHASUESE E SISTEMEVE SHKOLLORE

ITALI	SHQIPËRI	KINË	MAROK
Mosha	Mosha	Mosha	Mosha
Kopshti* 3-5 (3 vjet)	Kopshti 3-5 (3 vjet)	Kopshti 4 - 5 (3 vjet)	Kopshti Deri në 6 vjeç
Shkolla fillore ose Elementare 6-10 (5 vjet)	Elementare 6-9 (4 vjet)	Elementare 6-11 (6 vjet)	Elementare 7-12 (6 vjet)
Shkolla tetëvjeçare 11-13 (3 vjet)	Shkolla tetëvjeçare 10-13 (4 vjet)	Shkolla tetëvjeçare 12-14 (3 vjet)	Shkolla tetëvjeçare 13-15 (3 vjet)
Shkolla e mesme 14-18 (3-5 vjet)	Shkolla e mesme 14-17 (4 vjet)	Shkolla e mesme 15-18 (4 vjet)	Shkolla e mesme 16-17 /18 (2-3 vjet)

¹ Me përpilimin e këtyre faqeve janë marrë Bertonati Francesca, Coltri Marzia, Gavino Alessandro të koordinuar nga Vilma Bonezzi

PERU'	CILE	ECUADOR	ITALIA
Età	Età	Età	Età
Educacion Inicial 5 (1 anno)	Educación Parvularia 4 -5 (2 anni)	Guardería 4--5 (2 anni)	Scuola dell'infanzia* 3-5 (3 anni)
Escuela Primaria 6-11 (6 anni)	Escuela Básica 6-11 (6 anni)	Escuela Básica 6-11 (6 anni)	Scuola Primaria o Elementare 6-10 (5 anni)
Escuela secundaria 12-13 (2 anni)	Escuela secundaria 12-13(2 anni)	Escuela secundaria, bachillerato 12-17 (da 3 a 6 anni)	Scuola secundaria 1° grado 11-13 (3 anni)
Escuela Superior, bachillerato 14-16 anni (3 anni)	Universidad o Escuela superior 14-17 (4anni)	Ciclo de especializac'ion 18-19 (2 anni)	Scuola secundaria 2° grado 14-18 (3-5 anni)

SISTEMI SHKOLLOR ITALIAN


Kopshti (3-5 vjeç)

1
2
3





Shkolla fillore (6-10 vjeç)

1
2
3
4
5



Shkolla tetëvjeçare grada I (11 – 13 vjeç)

1
2
3



LICETË

LICEU KLASIK: studiohet latinisht, greqishte e vjetër, letërsi evropiane, art, histori dhe filozofi (në dy vitet e para studiohet edhe një gjuhë e huaj).

LICEU SHKENCOR: studiohet matematikë, shkencë, teknikë, latinisht, histori, filozofi, letërsi evropiane dhe një gjuhë e huaj.

LICEU ARTISTIK: studiohen arte teorike dhe praktike, studiohet gjithashtu italisht, histori, një gjuhë e huaj, drejtësi, ekonomi dhe filozofi.

LICEU I GJUHËVE: studiohet gjuhë dhe letërsi italiane, dy ose më shumë gjuhë të huaja dhe letërsi, studiohen gjithashtu latinisht, histori dhe filozofi.

LICEU SOCIAL-PSIKO-PEDAGOGJIK: studiohet gjuhë dhe letërsi italiane, latinisht, histori e filozofi dhe shkenca sociale (pedagogji, psikologji e sociologji).

LICEU I KOMUNIKIMIT: studiohet gjuhë dhe letërsi italiane, studiohet gjithashtu teatër, kinema, radio dhe televizion.

LICEU TEKNIK: studiohet gjuhë dhe letërsi italiane dhe tre gjuhë të huaja, studiohet gjithashtu informatikë, teknologji e informatikës, e komunikimit dhe rurale, vlerësim, ndërtim dhe ekonomi.

INSTITUTË TEKNIKË*

INSTITUTI TEKNIK PËR TURIZËM: studiohen gjuhë të huaja, informatikë, drejtësi, ekonomi, gjeografi dhe publicitet.

INSTITUTI TEKNIK TREGTAR: studiohet informatikë, drejtësi, ekonomi, gjeografi ekonomike dhe kontabilitet.

INSTITUTI TEKNIK INDUSTRIAL: studiohen drejtësi, ekonomi, informatikë, biologji, gjeografi, fizikë, kimi, teknologji dhe elektronikë.

INSTITUTI TEKNIK AERONAUTIK: studiohet gjeografi, shkenca natyrore, fizikë e kimi, aeroteknikë, fluturim ajror dhe meteorologji.

INSTITUTI TEKNIK NAUTIK (për lundrim): studiohen drejtësi, ekonomi, gjeografi, shkenca natyrore, fizikë, kimi, vizatim teknik, mekanikë, meteorologji dhe përfshihen ushtrime (stërvitje) praktike.

INSTITUTI TEKNIK PËR GJEOMETËR: studiohen fizikë e kimi, shkenca natyrore, gjeografi, ekonomi kontabilitet, vlerësim, topografi, ndërtim, projektim, drejtësi dhe ekonomi.

INSTITUTI TEKNIK PËR AKTIVITETE SOCIALE: studiohet edukim civil, informatikë, fizikë, shkenca natyrore, gjeografi, vizatim, ekonomi shtëpiake, drejtësi, shërbime sociale, kontabilitet, merceologji, pedagogji, psikologji, higjenë, muzikë dhe ushtrim / stërvitje praktike.

INSTITUTI I ARTIT: studiohen vizatim, teknologji, ekonomi, edukim civik, sociologji, filozofi, art (teori dhe praktikë).

INSTITUTË PROFESIONALË*

INSTITUT PROFESIONAL PËR SHËRBIMET E HOTELEVE: studiohen drejtësi dhe ekonomi, informatikë, ekonomi e ndërmarrjes, teknikë turistike administrative, gjeografi ekonomike dhe turistike, sekretari, raporte dhe ushqim. Parashikohen laboratore të ndryshme: kuzhinë, sallone, pritje, salla-bar, restoracion.

INSTITUT PROFESIONAL PER SHËRBIME TREGTARE: studiohen drejtësi dhe ekonomi, informatikë, gjeografi, histori e artit,

legjislacon, psikologji, vizatim, teknikë (e fotografisë dhe e publicitetit). Parashikohen gjithashtu laboratore informatike, teknikë administrative dhe të raporteve.

INSTITUT PROFESIONAL PËR BUJQËSI DHE AMBIENT: studiohen drejtësi dhe ekonomi, shkencat e tokës dhe biologji, kimi, ekologji agrare, teknikë (prodhime agro-ambientale), ekologji. Parashikohen gjithashtu laboratore për të gjitha disiplinat që i përkasin shkencës bujqësore.

INSTITUT PROFESIONAL PËR INDUSTRI DHE ARTIZANAT: studiohen lëndë teorike dhe pratike që ndryshojnë në bazë të profileve dhe të profesioneve: mekanikë, optikë, elektrik dhe elektronikë.

* **Bëj Kujdes:** në të gjithë Institutet Teknikë dhe Profesionale, përveç lëndëve të përshkruara studiohen gjithmonë gjuhë dhe letërsi italiane, histori, matematikë dhe anglisht.

KONSERVATORI I MUZIKËS: studiohen muzikë, instrumenta dhe kanto (teori dhe praktikë). Diploma që lëshon Konservatori njihet si Diplomë e Shkollës së Lartë të nivelit të parë, në rast se keni marrë Dëftesën e pjekurisë të Shkollës së Mesme